

Integrimi gjinor¹

Integrimi gjinor si mjet për nxitjen e barazisë gjinore është një çështje që prekë të gjitha aspektet e programit EJA Kosovo. Kjo përfshinë shqyrtimin e nevojave dhe rrethanave të grave, vajzave, djemve dhe burrave në hartimin, implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve. Integrimi gjinor nënkupton vlerësimin e mënyrës se si ndikon secili prej shërbimeve, projekteve, proceseve, politikave, veprimtarive dhe vendimeve në secilën pjesë të komunitetit, të meshkujve dhe femrave.

Ky udhëzues i shkurtër ofron një listë të përgjithshme të pyetjeve të cilën aplikantët e interesuar mund ta marrin parasysht dhe ta shqyrtojnë gjatë hartimit, implementimit, monitorimit dhe vlerësimit të projekteve/programeve të tyre.

ANALIZA E ÇËSHTJEVE GJINORE është hapi i parë që duhet të ndërmerret për të ekzaminuar marrëdhëniet dhe çfarëdo pabarazie midis grave dhe burrave, djemve dhe vajzave, si dhe gjendjes dhe pozicionit të tyre relativ në shoqëri. Kjo duhet të përfshijë: rolet dhe përgjegjësitë, identitetet, nevojat, prioritetet dhe interesat; ndarjen e punëve, qasjen dhe kontrollin ndaj parave, kompetencave dhe burimeve. Analiza e çështjeve gjinore duhet të aplikojë kornizën teorike të 'ndërthurjes' (intersectionality) për të theksuar mënyrat e shumëfishta në të cilat grupi i shënjestruar është në situatë të pafavorshme nga aspekti i identitetit gjinor, përkatësisë etnike, kulturës, moshës, racës, klasës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, religjionit etj.

Analiza e çështjeve gjinore – Disa koncepte kyçe

- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi
- Qasja dhe kontrolli ndaj burimeve dhe përfitimet nga këto të fundit
- Nevojat strategjike dhe praktike të grave dhe vajzave, si dhe të burrave dhe djemve
- Normat, vlerat, traditat, diskriminimi i dukshëm dhe i padukshëm, stereotipet
- Rolet e trefishta (në shtëpi, në punë dhe në komunitet)
- Të drejtat e njeriut
- Ndërthueshmëria (përkatësia etnike, moshja, aftësia e kufizuar, raca, orientimi seksual, kultura, edukimi, klasa shoqërore, etj.)

Të dhënat e zberthyer në bazë të gjinisë duhet të grumbullohen gjatë gjithë implementimit të programit /projektit, për t'i informuar dhe udhëzuar organizatat që të reagojnë ndaj pabarazive të konstatuara gjatë implementimit.

Disa pyetje që duhet të merren parasysht gjatë hartimit dhe implementimit të programit/projektit:

- Para fillimit të hartimit të projektit /intervenimit, a i merrni në konsideratë karakteristikat e grupit tuaj të shënjestruar?
- Si do të ndikoheshin gratë dhe burrat nga intervenimi juaj?
- A kanë me të vërtetë, gratë dhe burrat qasje të barabartë në ligj?
- A i konsideroni realitetet e ndryshme të jetesës së grave dhe burrave?
- A i konsideroni rolet gjinore dhe normat shoqërore dhe mënyrat se si ato ndikojnë tek gratë dhe burrat dhe si mund të reflektohen këto në projekt?
- Varësisht nga analiza e kryer mbi çështjet gjinore, a mendoni se programi/projekti i propozuar është i rëndësishëm për grupin e shënjestruar?
- A kontribuojnë aktivitetet e propozuara në fuqizimin e stereotipeve gjinore apo i sfidojnë ato?
- Gjatë hartimit të aktiviteteve, a i keni marrë parasysht pengesat dhe vështirësitë me të cilat do të mund të përballeshin gratë dhe/ose burrat për të marrë pjesë në to?
- A janë planifikuar aktivitete/takime në kohën dhe vendin ku mund të marrin pjesë gratë? A janë pyetur gratë dhe burrat se cila është koha dhe vendi më i përshtatshëm për t'u takuar?
- Në cilën ditë të javës dhe në çfarë ore e keni organizuar ngjarjen/aktivitetin tuaj? A është kjo e përshtatshme për njerëzit me përgjegjësi familjare?
- A e keni marrë parasysht perspektivën gjinore gjatë përgatitjes së buxhetit të projektit/programit? transportin publik ose alternativa të tjera miqësore për mjedisin për të reduktuar emetimet e karbonit?

¹ Informacionet e paraqitura në këtë udhëzues bazohen në analizën mbi çështjet gjinore të SIDA-së të kryera për KCSF dhe në politikën e brendshme të KCSF-së mbi integrimin gjinor. Për më shumë informata në lidhje me integrimin gjinor vizitoni Gender Toolbox të SIDA-së.

Bashkëfinancuar nga: